REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E MEDIAS

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

DREJTUAR BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE TË INTERESUARA.

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar, "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe të Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimin publik, Bashkia Kamëz njofton zhvillimin e një dëgjese publike në kuadër të procesit të konsultimit publik për projektaktin me objekt:

Titulli i Projektaktit që hapet për Konsultim Publik:

"Për pajisjen me leje mjedisi të tipit B për subjektin "2N" SHPK, me veprimtari "Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme"

Në vijim të këtij procesi, ftohen të marrin pjesë të gjithë qytetarët, banorët e zonës, përfaqësuesit e institucioneve vendore, shoqërisë civile dhe çdo grup apo individ i interesuar, me qëllim garantimin e një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje aktive të komunitetit.

Dëgjesa publike do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Datë: 24.11.2026
Ora: 10:00
Vendi: Rruga "Sado Kosheno", Babrru, nr.pasurie 100/120 Z.K 1066

Qëllimi i dëgjesës është informimi i publikut dhe marrja në shqyrtim e komenteve, mendimeve dhe

sugjerimeve lidhur me veprimtarinë e propozuar, në kuadër të procedurës për pajisjen me leje mjedisi të tipit B, për subjektin “2N” SHPK.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete, të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:
konsultim.publik@kamza.gov.al

Pranohen rekomandime deri më datën 24.11.2026.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme.